



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V_185_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_221_05_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_221_05_09;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Faik Munishi, "Mishtore Kaltrina" (shifra e konsumatorit DPR – 90010997) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së me datë 03.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 27.01.2009, lidhur me gjobën për shkyçje.

- Me datë 15.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar gjobat për shkyçje.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 27.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke i shpjeguar konsumatorit arsyet e shkyçjes.
Provë: Përgjigjia a KEK-ut e datës 28.01.2009
- Me datë 03.02.2009 konsumatorit ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit

- Me datë 17.10.2003 konsumatori ka nënshkruar me KEK Sh.A kontratën për riprogramimin e borxhit.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 15.07.2005 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 1,872.27 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 12.08.2005 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 23.08.2005 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 07.10.2005 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 2,417.10 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 02.11.2005 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 31.01.2006 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 2,685.93 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 16.03.2006 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 14.07.2006 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 2,958.90 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 28.09.2006 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit

- Me datë 22.11.2006 punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes tek konsumatori kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur pa lejen e KEK-ut dhe se për shkak të këtij veprimi punëtorët e KEK-ut me anë të urdhëresës për shkyçje sërish e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 05.12.2006 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 3,655.65 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 30.01.2007 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 04.04.2007 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 3,999.90 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 01.11.2007 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 3,263.78 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 03.03.2008 punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 07.07.2008 KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 3,263.78 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **refuzojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsyt e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Sipas nenit 4.7 të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ndërmarrja e energjisë ka të drejtë të ngarkoj me një taksë konsumatorin për përgatitjen e njoftimeve të shkyçjes, taksën për realizimin e shkyçjes si dhe gjobën në rast se konsumatori ri-kyçet në sistem pas shkyçjes pa pëlqimin e ndërmarrjes së energjisë. Të gjitha këto taksa dhe gjoba janë të përcaktuara në Shtojcën 1: Tabela e Çmimeve dhe Gjobjave të Rregullës mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve të aprovuar nga ZRRE.

2. Konsumatori duhet të lirohet nga njoftimi për shkyçje i datë 01.11.2007 ngase në këtë rast nuk ka vepruar sipas rregullës mbi shkyçjet dhe rikyçjet e konsumatorëve në sektorin e energjisë.
3. Të gjitha njoftimet tjera, shkyçjet dhe rikyçjet e konsumatorit janë bërë sipas rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar